



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 30, DATË 31.03.2021

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
Hetim Administrativ, iniciuar nga	<ul style="list-style-type: none">• APP <input type="checkbox"/>• Reklamim nga të tretë <input checked="" type="checkbox"/>
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	<p>1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me hartimin dhe argumentimin e kërkesave në ftesën për ofertë, për këtë procedurë prokurimi.</p> <p>2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për të kërkuar sqarime nga operatori ekonomik lidhur me dokumentacionin e paraqitur.</p> <p>3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 12 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, lidhur me evidentimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik fitues.</p>

Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 66 dhe 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi t’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 3 (tre) anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.